



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1612/2 Prot.

Rrëshen me, 29 . 04 . 2024

V E N D I M

Nr. 33 datë 26. 04. 2024

PËR

“NDYSHIM NË EMËRTIM OBJEKTESH NË VKB. NR. 6, DATË 31.01.2024 DHE VKB. NR. 23, DATË 18.03.2024, “PËR MIRATIMIN E FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA BUXHETI I VITIT 2023, PËR VITIN 2024”, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015", Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 97/2023, datë 07.12.2023, "Për buxhetin e vitit 2024", në Udhëzimin nr. 23, datë 30. 07. 2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar, në Udhëzimin nr. 1, datë 24.01.2024, "Për zbatimin e buxhetit 2024", në VKB. Nr.6, datë 31.01.2024 dhe VKB.nr. 23, datë 18.03.2024, "Për miratimin e fondeve të trashëguara nga buxheti i vitit 2023, për vitin 2024", projekt-vendimin së bashku me *relacionin nr. 1612, datë 22.04.2024* e paraqitur nga kryetari i bashkisë, këshillit bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshim në emërtim objektetsh në VKB. nr. 6, datë 31. 01. 2024 dhe VKB. nr. 23, datë 18. 03. 2024, "Për miratimin e fondeve të trashëguara nga buxheti i vitit 2023, për vitin 2024", bashkia Mirditë, si më poshtë vijon;

▪ **Emërtimi i objekteve:**

- a) Rikonstrukcion tualete shkolla Reps,.....700 000 lekë,
- b) Rikonstrukcion tualete, shkolla 9-vjeçare Rubik.....700 000 lekë,
- c) Rikonstrukcion tarraca, shkolla Industriale Profesionale Rubik.....1 000 000 lekë,
- d) Ndërtimi i dhomave të zhveshjes, në fushën e sportit Rubik;.....2 500 000 lekë.
Bashkohen në një emërtim – **“Rikonsruksion i objekteve arsimore dhe sportive, bashkia Mirditë”**, në vlerë totale;.....**4 900 000 lekë.**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

▪ **Emërtimi i objekteve:**

- a) Rikonstrukcion i sheshit të qytetit Reps;.....2 000 000 lekë,
b) Rikonstrukcion i tregut të fshatarëve Rrëshen;.....5 000 000 lekë,
c) Rikonstrukcion + ndriçim i sheshit qendër Fan;.....2 000 000 lekë.
Bashkohen në një emërtim – **“Blerje materiale ndërtimi e ndriçimi për punë dhe rikonstrukcione në territorin e bashkisë Mirditë”** në vlerë totale;.....**9 000 000 lekë.**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria juridike, prokurimeve dhe drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU



Nr. 1812 Prot
Dt. 22.09.24

**RELACION
PËR KËSHILLIN BASHKIAK MIRDITË**

Ne lidhje projekt-vendimin “Per ndryshim emertim objektesh ne VKB-ne nr. 06, date 31.01.2024 dhe nr. 23, date 18.03.2024, PER MIRATIMIN E PERDORIMIT TE FONDEVE TE TRASHEGUARA NGA VITI 2023 PER ATE 2024”, Bashkia Mirdite, per shqyrtim ne Keshillin Bashkiak me date 26.04.2024, ju relatojme per pikat si vijon:

Ne buxhetin e bashkise Mirdite, te miratuar edhe me VKB-ne nr. 06, date 31.01.2024 dhe nr. 23, date 18.03.2024, jane miratuar, nder te tjera, objektet si vijon:

1. Objektet

1	Rikonstruksion tualete shkolla Repts	Lekë	700,000
2	Rikonstruksion tualete shkolla 9 vjecare Rubik	Lekë	700,000
3	Rikonstruksion Taraca shkolla industriale Rubik	Lekë	1,000,000
4	Rikonstruksion dhoma zhveshje për fëmijët që stërviten në fushën e sportit Rubik	Lekë	2,500,000

Me shume totale 4'900'000 leke.

Duke qene se keto objekte jane te nje natyre te ngjashme dhe per ekonomi administrative propozohet qe keto te bashkohen ne nje te vetem dhe te riemertohen si vijon:

1	Rikonstruksion objekte arsimore e sportive (Nyjet sanitare shkolla Repts e shkolla 9 vjecare Rubik,Hidroizolim taraca shkolla industriale Rubik dhe Dhoma zhveshje për fëmijët që stërviten në fushën e sportit Rubik	Lekë	4,900,000
---	---	------	-----------

Me shume totale te pandryshuar prej 4'900'000 leke.

2. Objektet

1	Ndertim+Ndriçim sheshi qendra Nj.A Fan	Lekë	2,000,000
2	Rikonstruksion i tregut të fshatarëve	Lekë	5,000,000
3	Rikonstruksion+Ndriçim sheshi Repts qendra Nj.A Orosh	Lekë	2,000,000

Me shume totale 9'000'000 leke.

Duke qene se edhe keto objekte jane te nje natyre te ngjashme dhe serish per ekonomi administrative propozohet qe keto te bashkohen ne nje te vetem dhe te riemertohen si vijon:

1	Blerje materiale ndërtimi e ndriçimi për Punë dhe Rikonstruksione në territorin e Bashkisë Mirditë	Lekë	9,000,000
---	--	------	-----------

Me shume totale te pandryshuar prej 9'000'000 leke.

Projekt vendimi i propozuar nuk ndryshon thelbesisht asgje nga ajo qe eshte miratuar nga Keshilli Bashkiak, me VKB-ne nr. 06, date 31.01.2024 dhe nr. 23, date 18.03.2024, perveç se ben te mundur prokurimin me nga nje procedure prokurimi dhe jo me disa te tilla.

Gjithashtu ndryshon se objektet Ndertim+Ndriçim sheshi qendra Nj.A Fan, Rikonstruksion i tregut të fshatarëve, Rikonstruksion+Ndriçim sheshi Repts qendra Nj.A Orosh prokurohen si blerje materiale, me nje procedure prokurimi, nen objektin e riemertuar Blerje materiale ndërtimi e ndriçimi për Punë dhe Rikonstruksione në territorin e Bashkisë Mirditë dhe punimet kryhen nga vete Bashkia Mirdite nepermjet APPM-së.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Drejtori Ing. Genc Vladi



Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave

Drejtori Vjollca Gjoka



KRYETARI
Albert MËLYSHI

